



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 gusht 2024
Nr. ref.: RK 2509/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI250/23

Parashtrues

“IPKO Telecommunications Sh.P.K.”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit [Rev. nr. 538/2020] të Gjykatës Supreme të Kosovës,
të 14 marsit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga kompania “IPKO Telecommunications Sh.P.K.” (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës përfaqësohet nga Isamedin Dedinca, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 538/2020] të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) të 14 marsit 2022, në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 3369/2016] e Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) të 21 shkurtit 2020 dhe Aktgjykimin [C. nr. 325/2014] e Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) të 18 majit 2016.
3. Aktgjykimi i kontestuar [Rev. nr. 538/2020] i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 8 gusht 2023.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksi dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 3 nëntor 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 8 nëntor 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI250/23] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues, ndërsa përmes Vendimit [nr. KSH. KI250/23] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci, anëtarë.
8. Më 20 nëntor 2023, Gjykata: **(i)** njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës; **(ii)** i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe **(iii)** kërkoi nga Gjykata Themelore informata shtesë lidhur me datën e pranimit të Aktgjykimit [Rev. nr. 538/2020] të Gjykatës Supreme të 14 marsit 2023, nga parashtruesi i kërkesës.
9. Më 23 nëntor 2023, Gjykata pranoi një shkresë nga Gjykata Themelore lidhur me kërkesën e Gjykatës, e cila konfirmon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i ishte dorëzuar përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës më 8 shtator 2023.
10. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
11. Më 17 korrik 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta shpallë kërkesën të papranueshme për shqyrtim.

Përmbledhja e fakteve të rastit

12. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata konstaton se thelbi i procedurës gjyqësore pranë gjykatave të rregullta ndërlidhet me procedurën kontestimore të iniciuar nga personi R.I., kundër punëdhënësit të tij, përkatësisht parashtruesit të kërkesës. Më konkretisht, personi R.I., ka qenë në marrëdhënie të punës të lidhur me parashtruesin e kërkesës, e cila është ndërprerë nga parashtruesi i kërkesës në pajtim me nenin 11.4 të Ligjit Themelore të Punës, duke theksuar si bazë, *“mospërmbushjen e detyrave të punës të përcaktuara me kontratën e punës”*. Kundër këtij vendimi të parashtruesit të kërkesës, personi R.I., parashtroi ankesë në Panelin e Ankesave të punëdhënësit, duke kërkuar që vendimi i Komisionit Disiplinor për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të parashtruesit të kërkesës të anulohet. Paneli i Ankesave i punëdhënësit nxori Vendimin [nr. 596], përmes të cilit refuzoi si të pabazuar ankesën e personit R.I.
13. Duke pasur parasysh këtë, personi R.I., paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, ku kërkoi që padia të aprovohet si e bazuar dhe të refuzohet si i pabazuar Vendimi i Panelit të Ankesave [nr. 596] për shqiptimin e masës disiplinore të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.
14. Më 23 tetor 2009, Gjykata Komunale nxori Aktgjykimin [C.I. nr. 694/2009], në të cilin, nën pikën **I**. miratoi si të bazuar kërkesëpadinë e personit R.I, nën pikën **II**. anuloi si joligjor Vendimin [nr. 56] e Panelit të Ankesave, nën pikën **III**. detyroi të paditurën (parashtruesin e kërkesës) ta kthejë paditësen *“në punë dhe detyra të punës – Agjent për parandalimin e mashtrimeve në zyrën mbështetëse 2, ose në punët tjera që i përkasin përgatitjes së saj profesionale, me të gjitha të drejtat nga bazat e punës, nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, gjegjësisht nga data 19.02.2009 e deri në ditën e përfundimit të kontratës së punës të paditëses, respektivisht deri me datën 30.09.2011, sipas kontratës së punës pn. të datës 09.10.2008, krejt këtë në afat prej 7 ditësh, nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë”*.
15. Në Aktgjykimin e saj [C.I. nr. 694/2009], Gjykata Komunale, *inter alia*, theksoi se: *“...gjykata konsideron se vendimi i Panelit si organ i shkallës së dytë, në këtë rrethanë është pa vend, dhe në kundërshtim të drejtpërdrejt me vendimin e komisionit disiplinor si organ i shkallës së parë, me theksim, se as arsytimi i komisionit disiplinor në rrethanën e lartpërshkruar nuk qëndron, respektivisht provat mjekësore të ofruara nuk mund të refuzohen me preteks se janë të dyshimta dhe nuk duken autentike, pa u bërë më parë verifikimi i tyre pranë institucionit i cili ato i ka lëshuar.*

Në këtë drejtim, gjykata veçanërisht ka vlerësuar edhe vet kontratën e punës të datës 9.10.2008, në të cilën, përveç tjerash, në dispozitën e nenit 14, al. 1 është përshkruar se pas përfundimit të 6 /gjashtë/ muajve të punësimit, punonjësi ka të drejtë në 6/gjashtë/ ditë kohë të paguar pa konfirmim mjekësor, çka don të thotë, se edhe në situatë kur paditësja në të vërtetë ka qenë e sëmurë, thjesht nuk ka patur as obligim që të paditurës t’ia ofrojë provat mjekësore si arsytim për mungesën e bërë”.
16. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut, kundër Aktgjykimit [C.I. nr. 694/2009] të Gjykatës Komunale, duke pretenduar vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
17. Më 18 nëntor 2014, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin [AC. nr. 1540/2012], përmes të cilit aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të bazuar, ndërsa prishi Aktgjykimin [C1. nr. 694/2009] e Gjykatës Komunale dhe ktheu lëndën në rivendosje.

18. Në arsyetimin e Aktvendimit të saj [AC. nr. 1540/2012], Gjykata e Apelit, *inter alia*, theksoi:

“... një përfundim i tillë i gjykatës së shkallës së parë kjo gjykatë tani për tani nuk mund ta pranoj si të drejtë pasi që aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkëlqje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 n) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e kjo konsiston në faktin se dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës e kjo për faktin se në dispozitën e nenit 11.4 a) dhe b) është përcaktuar në mënyrë shumë të qartë se kur mund të shkëputet marrëdhënia e punës e në dispozitën e nenit 11.4 të Ligjit Themelor të Punës është paraparë se kontrata e punës shkëputet për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës si vijon: për shkak të mungesës së paarsyeshme nga puna dhe nën b) për shkak të gabimeve të përsëritura të cilat si të tilla nuk janë të mjaftueshme për të arsyetuar largimin nga puna, por ato me shpeshtësinë dhe peshën e tyre e çrregullojnë ecurinë normale të marrëdhënies së punës, e duke u mbështetur në këtë dispozitë ligjore dhe në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës rrjedhë se gjykata me rastin e vendosjes nuk i ka vlerësuar provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës si që është vërejtja zyrtare për mosrespektimin e orarit të punës e datës 17.11.2008 drejtuar paditëses ku kërkohet nga e njëjta që të respektohet orari i punës deri në ora 17,00 dhe mos të lëshohet 15 ose 20 minuta më herët por në ora 17.00...”

19. Më 18 maj 2016, Gjykata Themelore, në procedurën e përsëritur sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, nxori Aktgjykimin [C. nr. 325/2014], me të cilin:

në pikën **I.** miratoi kërkesëpadinë e personit R.I., si të bazuar;

në pikën **II.** anuloi si joligjor Vendimin e Panelit të Ankesave [nr. 56],

në pikën **III.** detyroi të paditurën (parashtruesin e kërkesës) që paditësen ta kthejë në punë dhe detyra të punës – agjent për parandalimin e mashtrimit në Zyrën Mbështetëse, ose në punët tjera që i përkasin përgatitjes së saj profesionale, me të gjitha të drejtat nga bazat e punës, nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, gjegjësisht nga data 19.02.2009 e deri në ditën e përfundimit të kontratës së punës së paditëses, respektivisht deri më datën 30.09.2011, sipas kontratës së punës.

20. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj [C. nr. 325/2014], Gjykata Themelore, *inter alia*, theksoi:

“Me dispozitën e nenit 11.2 të Ligjit Themelor në Kosovë, janë rastet kur nga ana e punëdhënësit punëtorit mund t'i shkëputet kontrata e punës, e ndër këto, në dispozitën e nenit 11.4 (a) edhe mungesa e paarsyeshme nga puna, dhe në pikën (b) gabimet e përsëritura, të cilat si të tilla nuk janë të mjaftueshme për të arsyetuar largimin nga puna, por ato me shpeshtësinë dhe peshën e tyre çrregullojnë ecurinë normale të marrëdhënies së punës, të cilat veprime në anën e paditëses në rastin konkret nuk kanë ekzistuar, kjo për arsye se paditësja të gjitha mungesat nga puna i ka arsyetuar me provat përkatëse mjekësore. Më në fund, e drejta shëndetësore është një nga të drejtat themelore të punëtorëve gjatë marrëdhënies së punës, dhe gjendja shëndetësore varet nga natyra e çdo individi dhe në të nuk mund të ndikon drejtpërdrejt asnjë punëtor.

Rrjedhimisht, janë pa kurrfarë baze theksimet e të paditurës të dhëna në vendimin e Panelit të Ankesave, të marrë në procedurën e rishqyrtimit të ankesës së paditëses, ku ceket se provat e ofruara si arsyetim për mungesën e paditëses me datën 16.01.2009 as që janë vlerësuar, për arsye se ato janë sjellë nga paditësja me vonesë prej më shumë se 30 ditë, kjo nga fakti se paditësja këto prova, në situatë kur në ditën e parë të lajmërimit të saj në punë, pas mbarimit të pushimit mjekësor...”

21. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës parashtror ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
22. Më 21 shkurt 2020, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [Ac. nr. 3369/16], ku në pikën **I.** të dispozitivit thuhet:

“REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e të autorizuarit të të paditurës dhe VËRTETOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 325/2014 i datës 18.05.2016 në pikën I, II dhe pjesërisht pika III e dispozitivit sa i përket pjesës së kërkesëpadisë me të cilën është detyruar e paditura që paditëses t’ia njoh të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Në pikën **II.** të dispozitivit thuhet:

“Me aprovimin e pjesshëm si të bazuar të ankesës së të autorizuarit të të paditurës, NDRYSHOHET aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 325/2014 i datës 18.05.2016, në pikën III (tre) të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë me të cilën është detyruar e paditura që paditësen ta kthejë në punë dhe detyra të punës – Agjent për parandalimin e mashtrimeve në zyrën mbështetëse 2 ose në punët tjera që i përkasin përgatitjes së saj profesionale”.

23. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj [Ac. nr. 3369/16], Gjykata e Apelit, *inter alia*, theksoi:

“Pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë sipas ankueses, Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar si të bazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit në cilësinë e provave ka administruar të gjitha provat me të cilat ka vërtetuar faktet vendimtare të çështjes në një proces të rregullt gjyqësor.

Sa i përket pjesës së ndryshuar si në pikën II (dy) të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë ka aplikuar gabimisht të drejtën materiale, kur ka gjetur se pjesa e kërkesëpadisë së paditëses për kthim në punë është e bazuar sepse me dispozitën e nenit 11.1 pika d) të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27 e datës 8 tetor 2001 shprehimisht parashihet se “Kontrata e punës shkëputet me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit”.

Në këtë rast duke marrë në konsideratë faktin se kontrata e punës e datës 09.10.2008 e lidhur në mes paditëses dhe të paditurit ka qenë e lidhur në afat të caktuar dhe atë për periudhën kohore prej datës 01.10.2008 deri me datë 30.09.2011, me çka me skadimin e afatit të kontratës paditëses edhe i ka pushuar marrëdhënia e punës, e marrëdhënia e punës e lidhur në kohë të caktuar krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese brenda periudhës së kohëzgjatjes së kontratës së punës dhe se me skadimin e kontratës së punës pushojnë të drejtat dhe detyrimet në raport me palët kontraktuese, del se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar e ka aprovuar këtë pjesë të kërkesëpadisë së paditëses si të bazuar. Andaj, është vlerësim i Gjykatës së Apelit se kërkesëpadia e paditëses për kthim në punë mbi bazën e arsyeve të sipërcituara duhet të refuzohet”.

24. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, e paditura brenda afatit ligjor paraqiti revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të LPK-së dhe

zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë të anulohet, si dhe kërkesëpadia të refuzohet si e pabazuar.

25. Më 14 mars 2022, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [Rev. nr. 538/2020], në dispozitivin e të cilit thuhet:

I. REFUZOHET pjesërisht i pathemeltë revizioni i të paditurës, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac. nr. 3369/16, datë 21.02.2020, në pikën I (një) të dispozitivit sa i përket vendosjes së në pikën I dhe II të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C. nr. 325/14, datë 15.08.2016.

II. APROVOHET pjesërisht i themeltë revizioni i palës së paditur, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac. nr. 3369/16, datë 21.02.2020, në pikën I (një) dhe III të dispozitivit sa i përket vendosjes si në pikën III dhe IV të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C. nr. 325/14, datë 15.08.2016, në pjesët ku është vendosur që paditëses ti njihen të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës si dhe shpenzimet e procedurës, lënda në këto pjesë i kthehet në rishqyrtim dhe vendosje gjykatës së shkallës së parë.

III. Mbetet i pashqyrtuar aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac. nr. 3369/16, datë 21.02.2020, në pikën II (dy) të dispozitivit.

26. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj [Rev. nr. 538/2020], Gjykata Supreme, përkitazi me mënyrën e vendimmarrjes, theksoi:

- i) "Lidhur me vendimmarrjen si në pikën I. të dispozitivit, Gjykata Supreme gjeti:

Kjo gjykatë vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta në procedurën gjyqësore të zhvilluar në këtë çështje kanë garantuar objektivitetin e procesit gjyqësor, barazinë e palëve në proces dhe ligjshmërinë e vendimmarrjes përmes vlerësimit të kërkesave ligjore si për procedurën ashtu edhe për të drejtën materiale. Në këtë mënyrë aktgjykimet, ligjshmëria e të cilave kontestohet përmes revizionit, janë mjaft të qarta, të rregullta në strukturë dhe përmbajtje.

Kjo gjykatë ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta se në rastin konkret paditëses i është ndërpre marrëdhënia e punës në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 11.4 të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë.

- ii) Lidhur me vendimmarrjen si në pikën II. të dispozitivit, Gjykata Supreme gjeti se:

Revizioni i të paditurës është vlerësuar i themeltë në pjesën e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë dhe shkallës së dytë ku është vendosur që paditëses ti njihen të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe pikën e dispozitivit që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës, ngase sipas Gjykatës Supreme kemi shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së. Kjo pasi që dispozitivi i aktgjykimit në këtë pjesë është i paqartë, i pa ekzekutueshëm dhe rrjedhimisht edhe në kundërshtim me arsyet e dhëna sipas të njëjtit aktgjykim.

Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë në këtë pjesë të aktgjykimit nuk kanë paraqitur arsye për faktet vendimtare, pra nuk dihet se cila është lartësia e pagës dhe të ardhurave të tjera që paditësja ka realizuar te e paditura që nga ndërprerja e marrëdhënies së punës e deri sa ka zgjatur kontrata e punës, nuk

është sqaruar fakti se gjatë kësaj periudhe paditësja a ka themeluar marrëdhënie të re të punës, përkatësisht a ka realizuar të ardhura personale.

iii) Lidhur me pjesën e aktgjykimit për kthimin e çështjes në rigjykim

Për pjesën e aktgjykimit ku çështja është kthyer në rivendosje, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në ri procedurë fillimisht të qartësohet se për cilat të drejta nga marrëdhënia e punës bëhet fjalë në këtë rast, pastaj nëse çështja ka të bëjë me pagesën e pagave dhe beneficioneve tjera nga marrëdhënia e punës duhet të vërtetohet lartësia përmes nxjerrjes së provës me ekspertizë financiare, njëherit duhet të vërtetohet fakti se paditësja në këtë periudhë a ka themeluar marrëdhënie pune - a ka realizuar të ardhura personale, duke kontribuar në zvogëlimin e dëmit të shkaktuar me humbjen e të ardhurave personale si rezultat i ndërprerjes së kundërligjshme të marrëdhënies së punës së paditëses”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktgjykimeve të gjykatave të rregullta i janë shkëlur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
28. Në mbështetje të shkëljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se procedura gjyqësore e zhvilluar në shkallë të parë, të dytë dhe në Gjykatën Supreme është në tërësi e parregullt, sepse vendimet gjyqësore janë nxjerrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Gjithashtu, ai pretendon se vendimeve u mungojnë arsyet mbi faktet vendimtare, arsyetimi mbi bazën e të cilit është vendosur nga trupat gjykuese.
29. Në mbështetje të kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore me Aktgjykimin [C. nr. 325/2014] të 18 majit 2016, në ri procedurë, veptoi në kundërshtim me Aktvendimin e “Gjykatës së Apelit të Kosovës numër AC. nr. 1540/2012 datë 18.11.2014”. Në mbështetje të kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se “Gjykata e Apelit me Aktvendimin AC. nr. 1540/2012 e kishte urdhëruar gjykatën e shkallës së parë që në ri procedurë t’i eliminoj të metat e në veçanti të administroj si prova dhe t’i vlerësoj veçanërisht provat e cekura siç janë, vërejtjet e njëpasnjëshme zyrtare të dërguara nga i padituri”.
30. Parashtruesi i kërkesës më tej konsideron se Gjykata e Apelit, “në Aktgjykimin [Ac. nr. 3369/2016] të 21 shkurtit 2020, nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet dhe kërkesat e të paditurës të paraqitura në ankesë para kësaj gjykate, pretendimet se Gjykata e Shkallës së parë në ri procedurë, nuk i kishte zbatuar vërejtjet e Gjykatës së Apelit respektivisht nuk i ka shqyrtuar as nuk i ka vlerësuar provat shkresore”.
31. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Gjykata e Supreme nuk i ka trajtuar dhe as nuk ka dhënë ndonjë arsyetim lidhur me kërkesat/prendimet e tij të paraqitura përmes revizionit. Njëlloj, ka neglizhuar edhe faktet dhe provat e propozuara, të cilat bashkërisht ishin me rëndësi vendimtare për të vendosur sa i përket bazueshmërisë së kërkesëpadisë së paditëses.
32. Në mbështetje të kësaj, parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Supreme është dashur t’i zbatojë dispozitat e nenit 160 paragrafët 160.4. dhe 160.5. të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në mënyrë që të nxirret një aktgjykim i cili i përmban

arsyet mbi faktet vendimtare, arsyetimi të jetë i qartë dhe të përmbajë kërkesat e palëve (në këtë rast të paditurës), si dhe faktet e paraqitura dhe provat e propozuara.

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimit të atakuar përmes kërkesës kushtetuese, për arsyet e shtjelluara më lart, i mungon plotësisht arsyetimi, pasi që ky arsyetim nuk është i qartë, nuk i përmban arsyet mbi faktet vendimtare, nuk i përmban kërkesat e të paditurës, nuk i vlerëson faktet dhe provat e propozuara, e që të gjitha këto kanë qenë të domosdoshme që të konsiderohet se ndaj të paditurës është zbatuar gjykimi i drejtë dhe i paanshëm.
34. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës potencon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme përmban të meta serioze dhe karakterizohet nga arsyetimet joadekuate, duke aluduar se e njëjta ka dështuar të arsyetojë besueshmërinë e refuzimit të pretendimeve të tij dhe se nuk i ka përmbushur parimet e përgjithshme lidhur me vendimin e arsyetuar gjyqësor të paraparë me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.
35. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të deklarojë kërkesën të pranueshme, të konstatojë shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, të deklarojë të pavlefshëm Aktgjykimin [Rev. nr. 538/2020], dhe të kthejë çështjen në rigjykim.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me lig”.*
[...]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6.1

(E drejta për një proces të rregullt)

1. *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme ... e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...”.*
[...]

LIGJI NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

DHËNIA, HARTIMI ME SHKRIM DHE DËRGIMI I AKTGJYKIMIT

Neni 160

„160.1 Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet ta ketë: pjesën hyrëse, dispozitivin, arsyetimin dhe udhëzimin mbi të drejtën e ankimit kundër aktgjykimit.

[...]

160.4 Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.

160.5 Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor.

[...]“

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

36. Gjykata fillimisht shqyrton nëse kërkesa ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë se:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

38. Gjykata i referohet edhe paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*

39. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të dorëzoj ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, nr. KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

40. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”.

41. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës: i. është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ii. konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 538/2020] të Gjykatës Supreme, të 14 marsit 2023; iii. ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; iv. ka specifikuar qartë të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe v. ka dorëzuar kërkesën brenda afatit prej 4 (katër) muajsh, siç përcakton neni 49 i Ligjit.
42. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 34 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton se:
- (2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.*
43. Gjykata së pari thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
44. Gjykata fillimisht thekson se rregulli i lartpërmendur, bazuar në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe praktikën e Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit të deklarojë pretendimet të papranueshme për arsye që kanë të bëjnë me meritat e rastit. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund ta shpallë një kërkesë të papranueshme në bazë dhe pas vlerësimit të meritave të saj, gjegjësisht nëse konsideron se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34. të Rregullores së Punës. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe të Gjykatës, kërkesa mund

të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm në lidhje me një pretendim specifik që mund të përmbajë kërkesa. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të klasifikohen në katër grupe të ndryshme: (i) pretendime që cilësohen si pretendime të "shkallës së katërt"; (ii) pretendimet e karakterizuara nga "një mungesë e qartë ose e dukshme e shkeljes"; (iii) pretendime “të pambështetura ose të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime "konfuze dhe të paqarta" (shih rastet e GJEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, aktgjykimi i 28 janarit 2011, paragrafi 55; [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, aktgjykim i 25 shtatorit 2008, si dhe rastet e Gjykatës [K104/21](#), parashtruesja e kërkesës [Nexhmije Makolli](#), aktvendimi për papranueshmëri i datës 13 prill 2021, paragrafi 26 dhe [K1107/21](#), parashtruesi i kërkesës [Ramiz Hoti](#), aktvendimi për papranueshmëri i datës 21 tetor 2023, paragrafi 53).

45. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
46. Megjithatë, para se Gjykata të vlerësojë bazueshmërinë e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ajo duhet të qartësojë thelbin e dispozitivit të aktgjykimeve të gjykatave të rregullta në raport me të cilat do të shqyrtojnë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në kontekst të arsyetimit të vendimeve gjyqësore.
47. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata rikujton se thelbi i kërkesës së parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me procedurën kontestimore e cila është iniciuar në Gjykatën Themelore nga personi R.I kundër parashtruesit të kërkesës si punëdhënësit të tij për shkak të ndërprerjes së paligjshme të marrëdhënies së punës. Procedura gjyqësore në Gjykatën Themelore dhe Gjykatën e Apelit përfundoi në atë mënyrë që vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të parashtruesit të kërkesës është anuluar si i paligjshëm në vendimet e të dyja gjykatave, ku parashtruesi i kërkesës është urdhëruar të kthente personin R.I në vendin e punës ku ka punuar, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.
48. Gjykata konstaton se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj konfirmoi se Vendimi i parashtruesit të kërkesës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së personit R.I është vendim i paligjshëm. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata gjen se Gjykata Supreme në të njëjtin Aktgjykim kishte konstatuar se: **i)** në një pjesë revizioni i parashtruar i parashtruesit të kërkesës është i themeltë lidhur me njohjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës, sepse, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, ka shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) i Ligjit për Procedurën Kontestimore. Kjo për arsye se dispozitivi i Aktgjykimit në këtë pjesë është i paqartë dhe i paekzekutueshëm dhe rrjedhimisht edhe në kundërshtim me arsyet e dhëna sipas të njëjtit Aktgjykim; **ii)** gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë në këtë pjesë të Aktgjykimit nuk kanë paraqitur arsye për faktet vendimtare, dhe rrjedhimisht nuk dihet se cila është lartësia e pagës dhe të ardhurave të tjera që paditësja ka realizuar te e paditura që nga ndërprerja e marrëdhënies së punës e deri sa ka zgjatur kontrata e punës, nuk është sqaruar fakti nëse gjatë kësaj periudhe paditësja ka themeluar marrëdhënie të re të punës, përkatësisht nëse ka realizuar të ardhura personale; dhe **iii)** Gjykata Supreme e ktheu çështjen në Gjykatën Themelore në rivendosje, por vetëm me qëllim të qartësimit se për cilat të drejta nga marrëdhënia e punës bëhet fjalë në këtë rast.

49. Prandaj, së pari, ajo që Gjykata konstaton në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është se Gjykata Supreme konfirmoi se Vendimi i parashtruesit të kërkesës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës personit R.I është i paligjshëm dhe se me këtë çështja e ligjshmërisë së tij është zgjidhur në tërësi. Megjithatë, Gjykata gjen se Gjykata Supreme nuk ka vendosur për të drejtat nga marrëdhënia e punës që do t'i takonin personit R.I nga një vendim i tillë i paligjshëm, por e ktheu çështjen në Gjykatën Themelore, e cila gjatë procedurës së përsëritur duhet të vendosë pikërisht për shtrirjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës të cilat i takojnë personit R.I. Prandaj, kjo pjesë e procedurës është në rivendosje pranë gjykatave të rregullta, dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk do t'i shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës në kontekst të këtyre të drejtave.
50. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se ajo në vijim do t'i shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkëlqje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, vetëm përkitazi me çështjen e arsytimit të vendimeve lidhur me ligjshmërinë e vendimit të parashtruesit të kërkesës, më konkretisht, nëse gjykatat e rregullta kanë arsyetuar në mënyrë mjaft të qartë se për çfarë arsye vendimi i parashtruesit të kërkesës për ndërprerje të marrëdhënies së punës me personin R.I, konsiderohet vendim i paligjshëm.
51. Thënë këtë, Gjykata thekson se e drejta për një vendim të arsyetuar është pjesë e pandashme e së drejtës për një gjykim të drejtë, e cila i detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, sepse mungesa e arsyeve të mjaftueshme dhe relevante në vendimin e gjykatës mund të tregojë, ndër të tjera, vendimmarrje arbitrare gjyqësore. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se gjykatat janë të detyruara t'i përgjigjen në mënyrë të detajuar çdo argumenti të paraqitur nga palët në procedurë, përkatësisht në ankesa ose parashtrësia të tjera përkatëse, por duhet t'u përgjigjen atyre argumenteve që janë kyçe dhe vendimtare për marrjen e një vendimi (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së [Ajdarić kundër Kroacisë](#), të 13 dhjetorit 2011, kërkesa numër 20883/09, pika 34 si dhe rastet e Gjykatës KI143/22, parashtrues Hidroenergy SH.P.K., aktgjykimi i 15 dhjetorit 2022, paragrafët 113-124; dhe KI164/23, KI173/23, KI174/23, KI175/23, KI176/23 i KI201/23, parashtruesit Murat Syla, Gentian Syla, Shqipe Kelmendi, Rinor Sogojeva, Asdren Mustafaj dhe Besnik Elshani, cituar më lart, paragrafët 148-150).
52. Gjykata rikujton se përkundër faktit që gjykata e brendshme ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e dëshmive, ajo është e detyruar të justifikojë veprimet e saj duke arsyetuar të gjitha vendimet e saj (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe rastin [Carmel Saliba kundër Maltës](#), nr. 24221/13, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73).
53. Gjykata gjithashtu rikujton qëndrimin e GJEDNJ-së, sipas të cilit neni 6 paragrafi 1 i obligon gjykatat që të japin arsye për vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga ato kërkohet një përgjigje e hollësishme për secilin argument të paraqitur (shih rastin e GJEDNJ-së, [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 29 janarit 1999, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).
54. Megjithatë, nëse parashtrësia e një pale është vendimtare për rezultatin e procedurës, ajo kërkon që t'i përgjigjet në mënyrë specifike dhe pa vonesë (shih, rastet e GJEDNJ-së [Ruiz Torija kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 30; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 28).

55. Prandaj, gjykatat e brendshme janë të obliguara që të shqyrtojnë, ndër të tjera, argumentet kryesore të palëve (shih rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 gushtit 2005, paragrafi 67; *Donadze kundër Gjeorgjisë*, nr. 74644/01, Aktgjykim i 7 qershorit 2006, paragrafi 35).
56. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës, çështjen e mungesës së arsytimit, e ndërlidh me faktin se Gjykata Themelore në riprocedurë nuk ka vepruar sipas gjetjeve të Gjykatës së Apelit, por kjo Gjykatë nuk mund të pajtohet me këtë, për arsye se në Aktvendimin [AC. nr. 1540/2012] e Gjykatës së Apelit, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk është zbatuar nga Gjykata Themelore, udhëzimet e dhëna nga Gjykata e Apelit për Gjykatën Themelore ndërlidheshin me vlerësimin e provave specifike që gjendeshin në shkresat e lëndës, të cilat nuk ishin vlerësuar dhe arsyetuar nga Gjykata Themelore, duke iu referuar në radhë të parë vlerësimin të njoftimeve zyrtare të parashtruesit të kërkesës, të datës 17.11.2008, 20.11.2008, 15.01.2009, të cilat njoftime i janë dërguar personit R.I.
57. Më konkretisht, Gjykata, në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në riprocedurë, vëren se Gjykata Themelore, në kundërshtim me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, kishte paraqitur dhe vlerësuar në mënyrë të detajuar të gjitha provat për të cilat Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj [AC. nr. 1540/2012] konstatoi se nuk kanë mbetur të pavlerësuar në Aktgjykimin e parë të Gjykatës Themelore. Për më tepër, Gjykata Themelore, në riprocedurë, kishte dhënë një arsyetim specifik për secilin njoftim zyrtar që parashtruesi i kërkesës ia dërgoi punonjësit të tij, përkatësisht personit R.I. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore korrigjoi lëshimet që kishte bërë në Aktgjykimin e saj të parë.
58. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Themelore, në riprocedurë, nuk ka trajtuar gjetjet e Gjykatës së Apelit nga Aktvendimi [AC. nr. 1540/2012], janë të pabazuara.
59. Gjykata më tej konstaton se parashtruesi i kërkesës edhe në Gjykatën e Apelit ngriti pretendimin për moszbatimin e gjetjeve të Gjykatës së Apelit nga Aktvendimi [AC. nr. 1540/2012] nga ana e Gjykatës Themelore në riprocedurë, por se ato si të tilla nuk janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit dhe për rrjedhojë nuk janë arsyetuar.
60. Gjykata nuk mund të pajtohet as për çështjen e këtyre pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se ato nuk janë të arsyetuara, për arsye se Gjykata e Apelit i kushtoi një pjesë të Aktgjykimit pikërisht pretendimeve ankimore të parashtruesit të kërkesës në lidhje me vlerësimin e provave, gjë që mund të shihet edhe në pjesën e arsytimit të Aktgjykimit në të cilën, ndër të tjera, thuhet se: “[...] gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit në cilësinë e provave ka administruar të gjitha provat me të cilat ka vërtetuar faktet vendimtare të çështjes në një proces të rregullt gjyqësor [...]”.
61. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit adresoi edhe çështjen e ligjshmërisë së vendimit të parashtruesit të kërkesës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së personit R.I, duke gjetur se nga provat e administruara është dëshmuar se vendimi është marrë me shkelje të dispozitës së nenit 11 të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë, i cili përcakton rastet kur punonjësit mund t'i shkëputet kontrata e punës nga punëdhënësi, në mesin e të cilave, në dispozitën e nenit 11.4 në pikën (a) është përcaktuar mungesa e paarsyeshme nga puna dhe në pikën (b) gabimet e përsëritura, të cilat si të tilla janë të mjaftueshme për ta arsyetuar largimin nga puna por ato me shpeshtësinë dhe peshën e tyre çrregullojnë ecurinë normale të marrëdhënies së punës,

- veprime të cilat në rastin konkret nuk ka pasur nga paditësja, sepse paditësja i ka arsyetuar të gjitha mungesat nga puna me provat përkatëse mjekësore.
62. Pikërisht një konstatim i tillë i Gjykatës së Apelit çoi në përfundimin e saj se vendimi i parashtruesit të kërkesës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së personit R.I, është vendim i paligjshëm.
 63. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është arsyetuar si për çështjen e a) pretendimeve se Gjykata Themelore nuk ka zbatuar gjetjet e Gjykatës së Apelit nga Aktvendimi, ashtu edhe për çështjen b) pse vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së personit M.N, nuk është vendim i ligjshëm.
 64. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës gjithashtu konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk është arsyetuar në pajtim me kërkesat e nenit 160 paragrafët 160.4 dhe 160.5 të LPK-s, duke theksuar se në vetë Aktgjykimin mungojnë arsyet për faktet vendimtare dhe se arsyetimi nuk është mjaft i qartë në lidhje me faktet e paraqitura dhe provat e propozuara.
 65. Gjykata duke shqyrtuar me kujdes dispozitën ligjore të nenit 160 të LPK-së, gjen se kjo dispozitë përcakton përmbajtjen e obligueshme të aktgjyimit, i cili në vetvete duhet të ketë si pjesën formale ashtu edhe pjesën materiale. Përmbajtjen formale e përbëjnë pjesët e aktgjyimit, ndërsa përmbajtjen materiale e përbën vetë përmbajtja e vendimit me të cilin pranohet ose refuzohet aktgjykimi. Duke iu referuar dispozitës së lartpërmendur për arsyetimin e aktgjyimit, Gjykata konstaton se ligjvënësi, përveç strukturës së aktgjyimit ose pjesës formale, ka përcaktuar edhe kornizat për përmbajtjen e aktgjyimit, posaçërisht për arsyetimin e aktgjyimit. Përmes përmbajtjes së përcaktuar, saktësohen hapat që duhet të ndiqen nga gjykata gjatë arsyetimit të aktgjyimit, për të siguruar që aktgjykimi, përveç zgjidhjes së drejtë dhe ligjore të një çështjeje, të sigurojë edhe besimin se gjykata ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe ligjore.
 66. Prandaj, dispozita e nenit 160 të LPK-së për përmbajtjen e arsyetimit të aktgjyimit, në fakt përcakton kornizat ose hapat që duhet të respektohen në arsyetimin e aktgjyimit, por është gjithashtu e rëndësishme të merret në konsideratë fakti se arsyetimi i aktgjyimit diktohet disi nga kërkesat dhe pretendimet/pohimet e palëve. Andaj, në arsyetimin e aktgjyimit, gjykata, përveç që duhet të ndjekë çdo hap në procedurën e dhënies së arsyetimit, duhet të japë arsyetimin e saj edhe duke u fokusuar në kërkesat, përkatësisht pretendimet/pohimet e palëve.
 67. Duke shikuar me kujdes arsyetimin e Aktgjyimit të Gjykatës Supreme në kontekst të dispozitës së lartpërmendur të nenit 160 të LPK-së, për të cilën parashtruesi i kërkesës konsideron se nuk është respektuar nga Gjykata Supreme, Gjykata gjen se Gjykata Supreme ka pranuar në tërësi konkluzionet e Gjykatës së Apelit pikërisht në lidhje me vlerësimin e paligjshmërisë së vendimit të parashtruesit të kërkesës. Në këtë drejtim, Gjykata vë në dukje se arsyetimi standard i një vendimi gjyqësor si segment i së drejtës për një gjykim të drejtë u mundëson gjykatave më të larta që thjesht të mbështesin arsyet e dhëna nga gjykatat më të ulëta si arsyetime, pa qenë nevoja të përsëriten ato arsye (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), të 21 janarit 1999, paragrafi 26, dhe [Kikabidze kundër Gjeorgjisë](#), Aktgjykim i 16 shkurtit 2022, pika 62), nëse nga rrethanat e rastit konkret nuk rezulton se gjykata e shkallës më të lartë nuk është marrë me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, përkatësisht nuk ka pranuar thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, [Talmane kundër Letonisë](#), të 13 tetorit 2016, pika 31).

68. Gjykata vëren se, në kundërshtim me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj iu përgjigj të gjitha kundërshtimeve ankimore që ajo i konsideroi të rëndësishme dhe relevante për të vendosur mbi meritat e kërkesës, përkatësisht për paligjshmërinë e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe se ajo ka dhënë arsye të vlefshme, të qarta dhe logjike për qëndrimin e saj në përputhje me kërkesat e nenit 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së.
69. Për më tepër, Gjykata gjen se Gjykata Supreme në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruesit të kërkesës se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk është në përputhje me nenin 182 paragrafi 2 pika n) të LPK-së, ishte e mendimit se dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në një pjesë, përkatësisht në pjesën që lidhet me vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit, është në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë dhe se përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për çështjen e paligjshmërisë së tij.
70. Më konkretisht, Gjykata Supreme konstatoi se arsyet e përdorura nga e paditura për marrjen e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës janë të paqëndrueshme, pasi personi R.I paraqiti prova të mjaftueshme se nuk ishte i pranishëm në punë për arsye shëndetësore, e drejtë kjo e garantuar me dispozitë ligjore, por në të njëjtën kohë këtë e siguronte edhe kontrata e punës, përkatësisht neni 14 paragrafi 1 i kontratës, ku përcaktohet se pas skadimit të gjashtë muajve të marrëdhënies së punës, i punësuari ka të drejtë në gjashtë ditë të pushimit të paguar pa vërtetim mjekësor. Nga kjo rezulton se nuk ka pasur arsye të një natyre të tillë që do të justifikonin ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditëses, andaj, në rrethana të tilla, Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e shkallës më të ulët kanë vendosur me të drejtë se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është i paligjshëm.
71. Megjithatë, Gjykata e sheh të nevojshme të deklarojë përsëri se Gjykata Supreme në revizion ka pranuar një pjesë të pretendimeve ankimore të parashtruesit të kërkesës për mosarsyetimin e një pjese të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit lidhur me faktet që janë përdorur nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit gjatë përcaktimit të të drejtave dhe detyrimeve nga marrëdhënia e punës të cilat duhet të përmbushen nga parashtruesi i kërkesës dhe të cilat rrjedhin nga një vendim joligjor. Kështu, Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj ka shpjeguar në mënyrë të detajuar se si Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit kanë bërë lëshime në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve nga marrëdhënia e punës në raport me personin R.I, dhe rrjedhimisht kjo pjesë e aktgjykimit është anuluar dhe është kthyer në rivendosje.
72. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme lidhur me çështjen e arsyetimit është në përputhje të plotë me përcaktimet ligjore të nenit 160 të LPK-së, dhe për rrjedhojë edhe me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, andaj, Gjykata edhe këto pretendime të parashtruesit të kërkesës i konsideron të pabazuara.
73. Si përfundim, Gjykata konsideron se gjatë procedurës së zhvilluar pranë gjykatave të rregullta, të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, lidhur me mosarsyetimin e vendimeve të gjykatave të rregullta, nuk janë shkelur për të gjitha arsyet e lartcekura.
74. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në tërësinë e saj, për arsye se pas analizës është konstatuar se pretendimet e parashtruesit të kërkesës kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë (iii) të pretendimeve të “pambështetura ose të paarsyetuara”, prandaj, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

75. Prandaj, kërkesa duhet të refuzohet në baza kushtetuese si e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113 (7) të Kushtetutës, parashihet me nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe siç specifikohet më tej me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës, më 17 korrik 2024, njëzëri,

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljajfi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

